



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 41**

**Datë: 10. 12. 2022. Ora: 11:30**

**Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.**

**Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.**

**Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Ibrahim Selmanaj, Rifat Krasniq, Gordana Llaban, Čemailj Kurtiši, Fazli Stollaj.**

**SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.**

**ZRPPC: Vesa Xharra, drejtoreshë u.d., e ZRCKFSP**

**Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami**

**Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.**

---

**RENDI I DITËS**

- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
- 2. Aktivitetet e SKQZ-së**
- 3. Raport për aktivitetet e Zyrës**

**-Certifikimi i kandidatëve të subjektit politik Levizjes Vetevendosje, për Kuvend komunal në Leposaviq**

- 4. Të ndryshme**

- 
- 1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**

Fillimisht, kryetari Radoniqi paraqiti rendin e ditës së takimit, dhe mbasi që nuk kishte vërejtje, propozime, u miratua rendi i takimit.

## **2. Aktivitetet e SKQZ-së:**

**Burim Ahmetaj**, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është duke vazhduar me përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar në komunat Mitrovcië e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Fushata e zgjedhjeve ka filluar më 8 dhjetor 2022 për tubime politike deri në ora 23:59 të datës 16 dhjetorit 2022 kur do të mbaron periudha 9 ditore e fushatës. Deri me tani nuk kemi ndonjë kërkesë nga subjektet politike do ti dorëzojnë Zyrtarit të Lartë Komunal të KKZ-së për zonën/vendin ku ata planifikojnë të mbahet ngjarja publike, hollësitë e ngjarjes, duke përfshirë kohën, lokacionin dhe çfarëdo informate tjetër që kërkohet nga autoritetet brenda periudhës kohore të përcaktuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2013. Gjithashtu, KKZ-te janë duke pritur nominime nga Subjektet Politike të certifikuara për zgjedhjet e 18 dhe 25 dhjetorit 2022, mirëpo sipas KKZ-ve, kemi numër të vogël të nominimeve për anëtar të KKV nga Subjektet Politike. Ftesë për nominime të KVV-ve i është dërguar edhe kandidatës së pavarur znj.Pantoviç, në komunën e Zvecanit, por që, deri me tani akoma nuk ka sjellë asnjë nominim. Gjithashtu edhe partia PKS në komunën e Leposaviqit, edhe pse ka pranuar ftesën nga Sekretariati, akoma nuk ka dorëzuar asnjë nominim për KVV. Periudha për nominimet për anëtar të KVV-ve përfundon me datë 10 dhjetor 2022 në ora 16:00.

Ndërsa, dje me datë 9 dhjetor 2022, në vijim të kryerjes së aktiviteteve tona zyrtare si Sekretariat i KQZ-së, kemi kërkuar nga KKZ-të, në secilën komunë përkatëse t'i identifikojnë personat që do të angazhohen si Staf Teknik të QV-ve për Zgjedhjet Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviç dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend Komunal në Zveçan dhe Leposaviç. E lidhur me këtë, Sekretariati i KQZ-se, ka kërkuar nga KKZ-të, që listat për stafin në fjalë t'i paraqesin në SKQZ, jo me vonë se, deri (të martën) me datë 13 dhjetor 2022.

Periudha e aplikimit për regjistrim për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet Komunale në Leposaviq dhe Zveçan, ka filluar me datën 6 dhjetor dhe ka përfunduar me datën 9 dhjetor 2022. Përgjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur asnjë aplikacion për regjistrim për votim jashtë Kosovës, për këto dy komuna.

Ahmetaj, raportoi edhe për Periudha e Kundërshtimit dhe Konfirmimit e Listës së votuesve për Zgjedhjet e parakohshme për Kuvendet Komunale në Leposaviq dhe Zveçan, e cila periudhë fillon me datën 11 dhjetor, dhe përfundon me datën 12 dhjetor 2022. Lidhur me përgatitjet për këtë periudhë, nesër nga

ora 9 deri ne ora 12, janë ftuar subjektet politike të certifikuar, për tu pajisur me CD që përmbajnë Listat preliminare të votuesve.

SKQZ, tha ai, ka zhvilluar pothuajse te gjitha aktivitetet e prokurimit për furnizime dhe shërbime për zgjedhjet që do të mbahën me 18 dhe 25 dhjetor. Sekretariati është duke punuar në dizajnimin e formave zgjedhore dhe pas miratimit nga KQZ, të hënën planifiohet të fillojë printimi i Formularëve zgjedhor ndërsa printimi i fletëvotimeve varësisht nga përgatitjet teknike pritet të fillojë sot ose nesër , ndërsa pjesa tjetër sa i përket furnizimeve dhe shërbimeve janë në proces. Nuk kemi ndonjë aktivitet të prokurimit i cili mund të rrezikohet, pasi që edhe kërkesat kanë qenë vlera të vogla.

Me datë 09 dhjetor 2022, kemi pasur reagimin nga Zyrtarët e Lartë Komunal të Zgjedhjeve përkatësisht ud. të ZLKZ Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok në lidhje me deklaratimet e anëtarëve të KKZ-ve nga Mbledhjet e KKZ-ve e dates 08 dhjetor 2022.

ZLKZ, tha në fund z. Ahmetaj, janë edhe kryesues të KKZ-ve nga komunat Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok deklarojnë se për asnjë moment nuk i kanë ikur dhe nuk i ikin përgjegjësisë me të cilën janë ngarkuar.

**Sami Kurteshi**, pyeti nëse, data e fundit është sot për nominimin e KVV-e...?

**Burim Ahmetaj**: Po...!

**Sami Kurteshi**: Propozoj të zgjatet deri të martën ! Dy ditë, tri më shumë...

**Ilir Gashi**: Mbrëmë e kemi mbajtur një mbledhje, dhe u cilësua nga mediat si e jashëtzakonshme, e fshehtë ! Po, ishte e fshehtë por, s'ishte e jashtëzakonshme...

Mbledhjet tjera, të jenë të qasshme për publikun, të mos bin ndesh me rregulloren...Temat tona janë publike...

Kryesuesi, mund ta ketë përcjellë një shkresë te Presidentja, por ajo shkresë nuk e ka marrë mendimin e të gjithëve...Kryesuesi, mund ta bëjë publike për media dhe opinion...

Ndërsa, e pyes kryeshefin se ku qëndron shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me ministrinë e brendshme, a është duke shkaur gjithcka në përputhje me planin operacional..?

**Arianit Elshani**: Edhe sipas raportit shihet se KQZ vazhdon me përgatitje, dhe zyrtarët tanë vazhdojnë të ushtrojnë detyrat e tyre dhe kanë gatishmërinë...! Ndërsa sa i përketë shkresës, unë takimin tonë mbrëmë e kam trajtuar si konsultativ dhe jo si takim të rregullt të KQZ, aty as nuk është votuar, ishte një shprehje

e vullnetit...Ftoj kryetarin që shkesën ta bëjë publike...Besoj që brenda asaj shkrese, është specifikaur se KQZ vazhdon përgatitjet, dhe insiston që të ketë siguri për mbajtje të zgjedhjeve...

Z. Elshani foli më gjatë në relacion me procesin, me përgatitjet, me hapat që duhet vazhduar në kuadër të planit operacional...

**Sami Hamiti**: Mbledhja ishte e mbyllur, jo e fshehtë ! Janë disa situata që ndodh kështu, mirëpo predidentja do të tregoj për cka jemi dakordue...Asnjë vendim nuk kemi marrë... U sqarue edhe ajo se, zyrtarët tanë janë të gatshëm me veprue, asnjë nuk ka dhënë dorëheqje dhe, ne jemi të gatshëm me veprue...

Në këtë pikë, diskutuan edhe: Alim Rama, Ilir Gashi, Kreshnik Radoniqi, Burim Ahmetaj, i cili foli rreth përgatitjeve, cështjes së sigurisë në relacion me planin e sigurisë, zgjatjen e afatit për nominimin e KVV që, propozoi të zgjatet deri më 13 dhjetor...!

Anëtarët e KQZ-së, me 11 vota për votuan që afati për nominimin e KVV-e të shtyhet deri më 13 dhjetor.

**Kreshnik Radoniqi**: Vazhdojmë me certifikimin e kandidatëve sipas vendimit të PZAP-së.

### **3. Raport për aktivitetet e ZRCKFSP**

**1. Vesa xhara**, u.d. e ZRCKFSP tha se, më 5 dhjetor KQZ ka marrë vendim për certifikim të 4 kandidatëve të subjektit politik Levizjes Vetevendosje, per Kuvend komunal ne Laposaviq, dhe kishte marrë vendim për refuzimin e 14 kandidatëve të tjerë.... Ky subjekt, ka parashtrur ankesë në PZAP, dhe kjo kërkesë është krhye në KQZ për rishqyrtim. Në përputhje me këtë, zyra rekomandon për certifikimin e këtyre 14 kandidatëve...

**Arianit Elshani**, tha se nuk kishim një dokument të qartë në bazë të ligjit – interpretimit të ligjit. Pra, sipas tij, kishte paqartësi në këtë aspekt, arsyetime dhe interpretime të anashkaluara... Ndërsa, **Ilir Gashi**, kërkoi që “përgjigja” dhënë PAZAP-së tu dërgohet anëtarëve të KQZ-së sepse, PAZAP sigursiht që ka lypë përgjigje në bazë të ankesës...Tash, e kemi një normë të re, e cila s’ishte më herët...

**Alim Rama**, tha se vendimet e KQZ bahen mbi faktet, dhe jo mbi aryestimet...! Ne pajtohemi ose jo, por KQZ me ligj certifikon listen...me këtë vendim, definohet “koha e korigjimit”, dhe mendoj që s’është hera e parë, por “listat” janë ndërru... “Koha e prerjes”, është vetëm certifikimi...

**Sami Hamiti:** Vendimet e PZAP-së, dihet duhet ti zbatohet por, me mendue se nga ai organ merren gjithmonë vendime të drejta dhe ligjore, kemi vendime të “gjykatës supreme” që i ka ndryshue “Gjykata kushtetuese”...Kur dorëzohet lista, lista dorëzohet në formë elektronike dhe të shkruar, janë formularët... Po, kemi korigjuar listen, por kurrë se kemi plotësue, sepse e ke dorëzue numrin e saktë, dhe në mesin e tyre ata që si kanë plorësue kriteret janë plotësue... Po flas nga praktika, për subjektin tim...

Këtë vendim, ne do ta zbatohet por, ky është precedan...Ky, është precedent i keq, por zyra do të ketë vetë probleme...

**Ibrahim Selmanaj:** Ne, askush nuk ka kundërshtim ndaj Lëvizjes Vetëvendosje, por ky është eprecedan sepse, “është afati, koha” dhe kjo ndërhyrje nuk bënë të bëhet... Ky precedan, nuk ban të përsëritet sepse, për këtë e kemi përcaktue afatin dhe ne dueht ta respektojmë...

**Arianit Elshani:** Krahas këtij vendimi, duhet të merret vendimi për përditësimin e broshurës...! Ne, e kemi bërë një votim, por tani duhet bërë ndryshim me këtë...

**Sami Kurteshi:** Me disa pajtohem, me disa nuk pajtohem...! Por, gjykatat vendosin precedentet, jo dikush tjetër...Deri në momentin që, ajo ankimohet, ndoshta unë personalisht nuk isha pajtue me këshillën juridike, por secili subjekt ende ka drejtë me e dretjue një ankesë në gjykatën supreme, pavarësisht vendimit...

Lëvizja Vetëvendosje, e ka kundërshtue pikërisht “këshillën juridike” që, e ka dhënë KQZ në ankesën e vet. Nuk po shoh arsye me e kundërshtue...

**Kreshnik Radoniqi:** Kush është për certifikimin e 14 kandidatëve të Lëvizjes Vetëvendosje...?

Me vota unanime, miratohet...

E kemi edhe ndryshimin e përmbajtjes së Broshures...?

Miratohet...

## **2. Të ndryshme !**